FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 45

Tiranë – E enjte, 24 mars 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 18.3.2022	Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, si dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare.....	6999
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 18.3.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 11.2.2022, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural".....	7000
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 124, datë 23.3.2022	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla.....	7001
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3773, datë 23.3.2022	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	7001
Udhëzim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 48, datë 8.2.2022	Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit, për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë administrativë, në gjykatë.....	7001

VENDIM
Nr. 173, datë 18.3.2022

PËR DHËNIEN E MBROJTJES SË PËRKOHSHME SHTETASVE UKRAINAS, PERSONAVE PA SHTETËSI DHE PERSONAVE QË KANË FITUAR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË UKRAINË, ME VENDQËNDRIM TË PËRKOHSHËM OSE TË PËRHERSHËM NË UKRAINË, SI DHE PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT TË KËRKUESVE TË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 82, të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve me shtetësi ukrainase, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, që hyjnë masivisht në territorin e Republikës së Shqipërisë për arsye të luftës, cenimit të jetës së civilëve të pambrojtur, përshkallëzimit të veprimeve të armatosura ndaj popullsisë civile, që kërkojnë mbrojtje nga Republika e Shqipërisë.

2. Mbrojtja e përkohshme jepet edhe për ata shtetas ukrainas apo persona pa shtetësi dhe persona që kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, të cilët kanë hyrë dhe po qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për shkaqet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Mbrojtja e përkohshme për këta shtetas fillon nga momenti i hyrjes në Republikën e Shqipërisë për një afat 1-vjeçar.

4. Përjashtohen nga e drejta e mbrojtjes së përkohshme të gjithë personat të cilët plotësojnë një nga kushtet e përcaktuara në nenin 83, të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".

5. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të vendosë që kërkuesit t'i kufizohet liria e lëvizjes, nëse e konsideron të nevojshme, bazuar në vlerësimin individual të secilit rast, sipas përcaktimeve të neneve 46 e 47, të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".

6. Krijimin e Task-Forcës, si një strukturë e posaçme e përkohshme me afat 1-vjeçar, për menaxhimin e fluksit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare nga shtetasit e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

7. Task-Forca kryesohet nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministrin e Arsimit dhe Sportit;
- Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrin e Drejtësisë.

7.1. Sipas nevojave, ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të tjera, me kërkesë të drejtuesit të Task-Forcës.

7.2. Kur për shkaqe të arsyeshme, ministri drejtues apo ministri anëtar nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë në vend të tij merr pjesë, përkatësisht, zëvendësministri, përfaqësues i ministrit në mungesë ose një përfaqësues i nivelit të lartë drejtues, i autorizuar prej tij.

8. Task-Forca e përmendur në pikën 7, të këtij vendimi, ka këto detyra:

a) Negocion me partnerët ndërkombëtarë për çështjet që lidhen me objektin e këtij vendimi;

b) Harton planin e veprimit për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare, përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi;

c) Koordinon situatën e pritjes dhe akomodimit të shtetasve, përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi;

ç) Evidenton nevojat emergjente për t'i paraprirë punës me ndryshimet e mundshme të kuadrit ligjor, nënligjor e rregullator, të cilat ndikojnë në përmirësimin në këtë funksion;

d) Analizon kërkesat shtesë buxhetore për funksionimin, shpenzimet dhe bazën e nevojshme materiale, si dhe koordinon fondet e donatorëve për këtë qëllim;

dh) Koordinon punën për marrjen e masave për arsimimin e përkohshëm dhe mbështetjen psikosociale të fëmijëve që i përkasin moshës së

arsimit parauniversitar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

9. Sekretariati teknik i Task-Forcës është drejtoria përgjegjëse për azilin, pranë Ministrisë së Brendshme.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 4, datë 18.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 11.2.2022, "PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 6 dhe nenit 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural"; të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022"; të pikës 5, të VKM-së nr. 101, datë 9.2.2022, "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022", ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 11.2.2022, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në kreun IV bëhen ndryshimet si më poshtë.

a) pas paragrafit të parë, shprehja "25.3.2022" zëvendësohet me shprehjen: "30.3.2022, ndërsa për masën mbështetëse nr. 10, deri më datë 29.4.2022";

b) në pikën 1, "Aplikimi *online*", shkronja "e" formulohet si vijon:

"Të gjithë aplikantët me status fermer ose person fizik/juridik që kryejnë aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, para përfitimit të financimit duhet të kenë plotësuar/përditësuar Regjistrin e Fermës pranë AREB-it".

2. Në kreun X/III bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) në pikën 1, fjalia "Të gjithë aplikantët, para aplikimit duhet të plotësojnë/përditësojnë Regjistrin e Fermës" zëvendësohet me formulimin "Të gjithë aplikantët, para pajisjes me kartën e naftës duhet të kenë plotësuar/përditësuar Regjistrin e Fermës pranë AREB-it";

b) pika 3 zëvendësohet me formulimin "Periudha e aplikimit është nga data 25.2.2022 deri në datën 30.3.2022";

c) pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me formulimin si vijon:

"Në rastet kur gjatë kontrollit administrativ evidentohen aplikime identike me ato të vitit 2021 (të realizuara nga i njëjti aplikant dhe me të njëjtin dokumentacion pronësie të tokës - certifikatë pronësie/APTP) mund të konsiderohet i vlefshëm konfirmimi përkatës i bërë nga ASHK/NJVV në vitin 2021".

3. Në kreun X/IV bëhen ndryshimet si vijon:

a) pika 8 zëvendësohet me formulimin "Gjatë procesit të kontrollit administrativ përgatiten lista pjesore, ndërsa në përfundim të tij përgatitet lista përfundimtare e aplikimeve të miratuara, si dhe lista përfundimtare e aplikimeve të skualifikuara";

b) pika 11 zëvendësohet me formulimin "Listat pjesore të përfituesve dhe lista përfundimtare e përfituesve me masën përkatëse të përllogaritur të naftës për subjektet përfituese publikohet në faqen zyrtare të internetit të AZHBR-së".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

URDHËR
Nr. 124, datë 23.3.2022

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës "b", nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në qarkun Durrës, Dibër dhe Korçë.
2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në qarkun Durrës, Dibër dhe Korçë.
3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë, vetëm për në thertore në qarkun Durrës, Dibër dhe Korçë me dokumentacionin e parashikuar sipas legjislacionit në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Ermira Gjeçi

NJOFTIM
Nr. 3773, datë 23.3.2022

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin të vitit 1957, nënshkruar në Madrid, më 4.10.2021, ka hyrë në fuqi më 17.3.2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

UDHËZIM
Nr. 48, datë 8.2.2022

PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E KOMPENSIMIT, PËR ORËT SHTESË TË KRYERA MBI KOHËN NORMALE TË PUNËS, NGA NËPUNËSIT CIVILË GJYQËSORË DHE PUNONJËSIT E TJERË ADMINISTRATIVË, NË GJYKATË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 95, 96 dhe 97, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, nenet 90 e 91, të ligjit nr. 7971, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 13.11.2019, "Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, ditët pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë" dhe udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018, të ministrit të Financave, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",

UDHËZON:

I. Të përgjithshme

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave më të detajuara dhe procedurës që duhet të ndiqet në gjykata, për rastet kur nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të administratës gjyqësore në gjykatë, do t'u kërkohet të kryejnë orë shtesë mbi kohën normale dhe mënyrën e kompensimit të këtyre orëve shtesë. Ky udhëzim do të bëjë të mundur njehsimin e praktikës për trajtimin e orëve shtesë të punës që kryhen si dhe të rritjes së transparencës, në përdorimin e fondeve buxhetore me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

II. Përkufizime

Në kuptim të këtij udhëzimi termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Nëpunës", janë të gjithë nëpunësit sipas kategorive të nëpunësve civilë gjyqësorë të parashikuar në pikën 1, të nenin 50, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor" si dhe punonjësit e tjerë në gjykatë që kryejnë veprimtari të cilat nuk kryhen nga nëpunësit civilë gjyqësorë.

2. "Epror i drejtpërdrejtë", do të konsiderohet:

a) kryetari i gjykatës për kancelarin, si dhe për këshilltarin dhe ndihmësin ligjor;

b) kancelari për të gjithë nëpunësit e gjykatës që nuk janë përfshirë në shkronjën "a" të kësaj pike;

III. Mbi mënyrën e kompensimit të orëve shtesë pune të kryera mbi kohën normale nga nëpunësi

1. Nëpunësi, nuk mund të kryejë më shumë se 8 orë shtesë pune në javë dhe 200 orë në vit mbi kohën normale të punës.

2. Në raste të veçanta, kur konstatohet se për organizimin dhe sigurimin e funksionimit të shërbimeve në mbështetje të sistemit gjyqësor, është e nevojshme puna jashtë kohës normale të punës, nëpunësit, mund t'i kërkohet nga eprori i drejtpërdrejtë, të punojë mbi kohën normale të punës, por jo më shumë sesa është parashikuar në këtë vendim dhe në legjislacionin në fuqi.

3. Në çdo rast, kërkesa për punë jashtë orarit për nëpunësin bëhet pas marrjes së miratimit nga kryetari i gjykatës.

4. Mënyra e kompensimit të orëve shtesë mbi kohën normale të punës do të jetë me orë/ditë pushimi, dhe, në raste të veçanta, me kompensim financiar.

IV. Procedura për miratimin dhe kompensimin e orëve shtesë të punës

5. Në rast të konstatimit të nevojave që dalin në gjykatë, për punë jashtë orarit normal të punës të nëpunësit, ndiqen hapat si më poshtë:

a) Kancelari i gjykatës, për kategoritë e nëpunësve për të cilët sipas këtij udhëzimi konsiderohet epror i drejtpërdrejtë, harton kërkesën drejtuar kryetarit të gjykatës, duke argumentuar nevojën për kryerjen e orëve shtesë mbi kohën normale të punës nga nëpunësi civil gjyqësor;

b) Kryetari i gjykatës, në rast të miratimit të kërkesës së propozuar nga kancelari, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, nxjerr urdhrin për kryerjen e punës mbi kohën normale të punës, ku përcakton: detyrën që do të kryhet, kohën kur do të kryhet puna, nëpunësin që ngarkohet për kryerjen e kësaj detyre, si dhe caktimin e kancelarit ose të një personi tjetër, me përgjegjësinë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri. Kur kryetari i gjykatës është epror i drejtpërdrejtë i nëpunësit, urdhri i nxjerrë prej tij, për orë shtesë, ndër të tjera duhet të përmbajë dhe argumentimin e nevojave që ka gjykata për kryerjen e orëve shtesë nga nëpunësi;

c) Në rastin e punonjësve që lidhen për shkak funksioni me gjyqtarin e gatshëm, urdhri për grafikun e gatishmërisë shërben si bazë për autorizimin e kancelarit për lejimin e punës jashtë orarit;

ç) Personi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të urdhrit, merr masat e duhura për të siguruar realizimin e detyrës së caktuar, si dhe për të dokumentuar punën e kryer gjatë orëve shtesë.

6. Nëpunësi, për orët e punës shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, kompensohet me orë/ditë pushimi, të barabartë me orët shtesë të kryera plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune apo me orët shtesë të kryera plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00–6:00.

7. Në përgjithësi, nëpunësi, për punën e kryer jashtë kohës normale të punës, nuk kompensohet financiarisht. Vetëm në raste përjashtimore, dhe vetëm të një pamundësie të kompensimit me pushim për orët shtesë të punës së kryer, nëpunësi mund të kompensohet financiarisht.

8. Në rast se brenda 2 muajve nga dita e kryerjes së punës, kryetari i gjykatës, vlerëson se është e

pamundur kompensimi i punës së kryer mbi kohën normale të punës me orë/ditë pushimi, vendos kompensimin financiar të punonjësve.

9. Kompensimi financiar i nëpunësit civil gjyqësor për orët e punës shtesë të kryera mbi kohën normale të punës është në masën, plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune dhe plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00–6:00.

10. Për kryerjen e kompensimit financiar, kryetari i gjykatës, nxjerr urdhrin, ku të përcaktohet nëpunësi përfitues, koha dhe orët shtesë të kryera si dhe masa e kompensimit financiar. Urdhri i dalë për këtë qëllim duhet të mbështetet edhe në dokumentacionin justifikues si më poshtë:

a) kërkesën e bërë me shkrim nga eprori i drejtpërdrejtë i nëpunësit në të cilën kërkohet kompensimi financiar për orët shtesë të kryera, si dhe argumentimin e pamundësisë për kompensimin me orë/ditë pushimi të nëpunësit. Kur kryetari i gjykatës është epror i drejtpërdrejtë i nëpunësit, urdhri i nxjerrë prej tij, për kompensim financiar, ndër të tjera, përmban edhe argumentimin e pamundësisë për kompensimin me orë/ditë pushimi të nëpunësit;

b) informacion/procesverbal ku dokumentohet realizimi i detyrës së caktuar, koha dhe orët shtesë të kryera.

11. Programimi i fondeve buxhetore të nevojshme për shpenzime, për orët shtesë, mbi kohën normale të punës, të bëhet gjatë procesit të hartimit të projektbuxhetit të vitit pasardhës nga secila gjykatë.

12. Ngarkohet Departamenti i Administrimit dhe Programimit të Buxhetit për hartimin e modeleve sipas pikave 10/a dhe 10/b.

13. Ngarkohet Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe Departamenti i Administrimit dhe Programimit të Buxhetit për auditimin dhe monitorimin e këtij udhëzimi.

14. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen gjykatat e të gjitha niveleve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

Model 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA _____

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____.____.2022

URDHËR

Nr._____, datë _____. _____.2022

Për kryerjen e kompensimit financiar të nëpunësve dhe punonjësve, në administratën gjyqësore, që kanë punuar mbi kohën normale të punës

Bazuar në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjin nr. 7971, datë 12.7.1995, "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 732, datë 13.11.2019, "Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë", udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, udhëzimin nr. 48, datë 8.2.2022, "Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit, për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësore dhe punonjësit e tjerë administrativë në gjykatë", të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

URDHËROJ:

1. Të kryhet kompensimi financiar, për z._____, me detyrë_____, për orët e punës shtesë të kryera mbi kohën normale të punës.
2. Kompensimi financiar të kryhet për gjithsej xx orë shtesë të realizuara (*sipas rastit*, *në ditë të zakonshme pune / ditë pushimi / ditë feste / apo nga ora 22:00–06:00)*, sipas procesverbalit të dokumentimit të realizimit të detyrës së ngarkuar, (*koha kur është kryer dhe sasia e orëve shtesë të kryera).*
3. Masa e kompensimit financiar do të jetë në vlerën prej xxxx lekë *(1 orë = xx lekë x 125% = xx lekë).*
4. Struktura përgjegjëse për buxhetin dhe financën, të kryejë pagesën, mbështetur në dokumentacionin justifikues dhe vërtetues (*kërkesa e bërë me shkrim nga eprori i drejtpërdrejtë i nëpunësit për të cilin kërkohet kompensimi financiar për orët shtesë të kryera, argumentimi i pamundësisë për kompensimin me orë/ditë pushimi të nëpunësit, informacion/ procesverbali ku dokumentohet realizimi i detyrës së caktuar, koha dhe orët shtesë të kryera).*
5. Me zbatim e këtij urdhri ngarkohet kancelari dhe struktura përgjegjëse për buxhetin dhe financën.

KRYETARI

Adresa:

Model 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA _____

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____.____.2022

Lënda: *Kërkesë për kompensimin financiar, të nëpunësve dhe punonjësve, që kanë kryer orë shtesë, mbi kohën normale të punës.*

Drejtuar: Znj./Z. _____,
Kryetar i Gjykatës,
Nga: Znj./Z. _____,
Kancelar i Gjykatës/ person i ngarkuar,

Në zbatim të urdhrit nr. ___, datë __.__.2022, "Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësve dhe punonjësve, mbi kohën normale të punës", nëpunësit dhe punonjësit, kanë kryer detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara:

- A..... me detyrë_____, ka punuar mbi kohën normale të punës, në datat _____, gjithsej _____ orë shtesë mbi kohën normale.

- B..... me detyrë _____, ka punuar mbi kohën normale të punës, në datat _____, gjithsej _____ orë shtesë mbi kohën normale.

Për sa më sipër, duke qenë se është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë të punuara _____ në zbatim të VKM-së nr. 732, datë 13.11.2019, "Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë" dhe udhëzimit nr. 48, datë 8.2.2022, "Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit, për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë administrativë në gjykatë", të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sugjerojmë kompensimin financiar të nëpunësve dhe punonjësve, që kanë kryer orë shtesë, mbi kohën normale të punës.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

KANCELARI / PERSONI I NGARKUAR

Adresa:

Model 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA_____

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____.____.2022

Lënda: *Mbi argumentimin e pamundësisë për kompensimin me orë/ditë pushimi të nëpunësit dhe punonjësve në administratën gjyqësore,* që *kanë kryer orë shtesë, mbi kohën normale të punës.*

Drejtuar: Znj./Z. _____,
Kryetar i Gjykatës,
Nga: Znj./Z. _____,
Kancelar i Gjykatës/ person i ngarkuar,

Në zbatim të urdhrit nr.___, datë __.__.2022, "Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësve dhe punonjësve, mbi kohën normale të punës", nëpunësit dhe punonjësit, kanë kryer detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara, bazuar në procesverbalin datë ___.___.2022, mbi dokumentimin e realizimit të detyrës së caktuar, koha dhe orët shtesë të kryera, si më poshtë:

- A..... me detyrë _____, ka punuar mbi kohën normale të punës, në datat _____, gjithsej_____ orë shtesë mbi kohën normale.

- B..... me detyrë _____, ka punuar mbi kohën normale të punës, në datat _____, gjithsej_____ orë shtesë mbi kohën normale.

Duke qenë se ka qenë e pamundur kompensimi me orë/ditë pushimi brenda periudhës 2-mujore nga kryerja e orëve shtesë të punuara, për shkak të ngarkesës së madhe dhe veprimtarisë së pandalshme, pasi ndërprerja e punës cenon drejtpërdrejt funksionimin normal të veprimtarisë së gjykatës ____ *etj., argumente* _____.

Për sa më sipër, duke qenë se është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë të punuara, në zbatim të VKM-së nr. 732, datë 13.11.2019, "Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë" dhe udhëzimit nr. 48, datë 8.2.2022, "Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit, për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë administrativë në gjykatë", të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sugjerojmë kompensimin financiar të nëpunësve dhe punonjësve, që kanë kryer orë shtesë, mbi kohën normale të punës.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

KANCELARI/ PERSONI I NGARKUAR

Adresa:

Model 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA_____

Procesverbal

I mbajtur sot më datë _____._____.2022, në ambientet e gjykatës_____, nga kancelari i gjykatës/ personi i ngarkuar, nga njëra anë dhe znj./z. _____, me detyrë _____, nga ana tjetër, mbi dokumentimin e realizimit të detyrës së caktuar, kohës dhe orët shtesë të kryera, sipas *urdhrit nr.__, datë __.__.2022, Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësve dhe punonjësve, mbi kohën normale të punës,* nga ku rezultoi se:

Bazuar në *urdhrin nr.__, datë __.__.2022, Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësve dhe punonjësve, mbi kohën normale të punës,* nëpunësit dhe punonjësit, kanë kryer detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara. Nëpunësit dhe punonjësit, kanë kryer gjithsej xx orë shtesë të realizuara (*duke i përcaktuar sipas rastit*, *në ditë të zakonshme pune / ditë pushimi / ditë feste / apo nga ora 22:00–06:00).*

Ky procesverbal mbahet në dy kopje, ku njëra kopje mbahet nga kancelari i gjykatës/ personi i ngarkuar, të cilin e bën pjesë të praktikës, ndërsa kopja tjetër tërhiqet nga nëpunësi/punonjësi, që ka kryer orë pune shtesë mbi kohën normale të punës.

Kancelar i Gjykatës/ Person i ngarkuar **Nëpunësi/punonjësi**

Adresa:

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 45
Datë: 2022/03/24 15:08:40
63ff56e8-99e7-4577-9aba-a3b67dd7842b

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë